

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent-Lektor” në Departamentin e Mekanikës, për mbulimin e lëndëve “Shkencë Konstrukione 2” dhe “Mekanikë e Aplikuar në Makina 1” duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Konstrukion Makinash dhe Mjete Lëvizëse.
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare, të dy cikleve jo më të ulët se 8 (tetë).
3. Të zotërojë një gjuhë të huaj me dëshmi (Preferohet anglisht).

Kriteret specifike qe duhet të plotësojnë kandidatet në pozicionin “Asistent-Lektor” janë:

4. Nota në lëndët “Shkencë Konstrukione 2” dhe “Mekanikë e Aplikuar në Makina” të jetë mbi 9 (nëntë).
5. Preferohet të ketë eksperiencë pune në sektorin e transportit.
6. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitete kërkimore-shkencore në fushën përkatëse.
7. Të ketë aftësi komunikuese për transferimin e dijeve tek studentet.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent-Lektor” në Grupin Mësimor të Materialeve pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet në Inxhinieri Materiale në Shqipëri ose jashtë vendit në sistemin 5 vjeçar ose sistemin 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave).
2. Të ketë notë mesatare të studimeve universitare (3+ 2) mbi 8.0.
3. Preferohen kandidatët te cilët kanë zhvilluar kualifikime universitare jashtë vendit.
4. Të ketë eksperiencë pune mbi 8 vjet në industri, në fushën e inxhinierisë së materialeve, preferohet në prodhim te fibrave industriale dhe materialeve kompozite, teknologjive te avancuara te prodhimit.
5. Të zotërojë me dëshmi/certifikatë një gjuhë të huaj (preferohet anglisht).
6. Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.
7. Preferohen kandidatët me eksperiencë në kërkimin shkencor, menaxhim projektesh dhe start-up.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **07.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.